

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа (“Службен весник на Република Македонија” бр. 58/00, 44/02 и 82/08) и член 25 став 2 од Законот за основно образование (“Службен весник на Република Македонија бр. 103/08) министерот за образование и наука ја утврди наставната програма по предметот *албански јазик* за VIII одделение на осумгодишното основно образование, односно IX деветгодишното основно образование.

**НАСТАВНА
ПРОГРАМА**



**МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО**

АЛБАНСКИ ЈАЗИК

ОСНОВНО ОБРАЗОВАНИЕ

Скопје, септември 2009 г.

ЗАБЕЛЕШКА:

Согласно динамиката за воведување на деветгодишното основно воспитание и образование, наставната програма за учениците во VIII одделение на осумгодишното основно училиште од учебната 2010/11 година е еквивалентна на наставната програма за IX одделение на деветгодишното основно училиште.

Според наставниот план за предметот *албански јазик* се планирани по 4 часа неделно, односно 144 наставни часа годишно.

Наставниот предмет *албански јазик* во наставниот план има статус на задолжителен наставен предмет.

1. QËLLIMET E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË KLASËN IX

Nxënësit:

- t'i thellojnë njohuritë dhe aftësitë për përdorimin e drejtë të Gjuhës letrare shqipe;
- ta njohin shtrirjen gjeografike dhe dallimet kryesore të dialekteve të Gjuhës shqipe;
- të aftësohen ta përdorin drejt shumësin e emrave dhe të mbiemrave...;
- t'i përdorin drejt trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave vetorë...;
- t'i dallojnë përcaktuesit e shprehur me emër, mbiemër, përemër e numëror;
- të njohin veçoritë kuptimore dhe gramatikore të përemrave lidhorë e të pacaktuar dhe përdorimin e drejtë të tyre;
- të përvetësojnë zgjedhimin e foljeve në mënyra e kohë të ndryshme...;
- t'i njohin foljet e parregullta dhe foljet ndihmëse dhe të aftësohen t'i përdorin drejt në të shprehur;
- t'i thellojnë njohuritë mbi strukturën e grupit emëror dhe mbi funksionin e tij në kuadër të fjalisë;
- t'i thellojnë njohuritë mbi strukturën themelore të fjalisë (njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe) dhe ta përvetësojnë rendin e zakonshëm të përbërësve të saj;
- t'i zgjerojnë njohuritë mbi përdorimin e rrethorëve si gjymtyrë të dyta të fjalisë;
- t'i njohin mënyrat e ndërtimit të fjalive të përbëra me më shumë se dy pjesë dhe mjetet e lidhjes së tyre;
- t'i njohin fjalitë e nënrenditura - funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjave të pikësimit;

- të dallojnë sonetin dhe poezinë satirike nga llojet e tjera;
- t'i dallojnë dhe të aftësohen t'i përdorin figurat letrare: asindetin, polisindetin, pyetjen retorike, anaforën dhe epiforën;
- të aftësohen të diskutojnë për motivin, idenë dhe temën e poezisë;
- të dallojnë ritmin në poezinë lirike;
- të dallojnë tregimin nga novela dhe romani;
- t'i dallojnë llojet e ndryshme të romanit;
- të njihen me strukturën e dramës dhe t'i dallojnë elementet letrare nga ato skenike;
- të aftësohen të bëjnë shkrime kreative dhe me gjuhë të figurshme;
- të njihen me mjetet shprehëse të artit filmik dhe të dallojnë filmin nga artet tjera, veçmas nga arti letrar...

2. QËLLIMET KONKRETE

FUSHA PROGRAMORE: GJUHË (50 orë)			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
KREU I: Drejtshkrim			
<p>Nxënësit:</p> <p>- të aftësohen t'i përdorin drejt zanoret: a, ë, u, grupet e zanoreve: ua, ye, ia, ua; bashkëtingëlloret e zëshme: s, sh, z, zh, ç, në fillim të fjalës, si dhe grupet e bashkëtingëlloreve: mb, nd, ng, ngj.</p>	<p>- Probleme të drejtshkrimit të zanoreve e të bashkëtingëlloreve</p>	<p>- Drejtshkrimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve</p>	<p>- Ushtrime me tekste të zgjedhura nga arsimitari për t'i shkruar drejt dhe pa gabime zanoret, bashkëtingëlloret dhe grupet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve.</p>
<p>- të aftësohen ta përdorin drejt shumësin e emrave dhe mbiemrave (të emrave të gjinisë femërore që në njëjësin e pashquar mbarojnë me i, e, a ose o të theksuar; të emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me a; mbiemrave që përcaktojnë emrat mashkulorë me shumësin në e; nyjave të përparme tek emrat në rasën gjinore - i, e, të, së);</p> <p>- të përdorin drejt shkronjën e madhe tek emrat dhe mbiemrat e personave, epitetet (ofiqet) dhe pseudonimet tek emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare...;</p>	<p>- Probleme të drejtshkrimit të emrave dhe të mbiemrave</p>	<p>- Drejtshkrimi i emrave dhe mbiemrave</p>	<p>- Ushtrime për drejtshkrimin e emrave dhe mbiemrave, që mund të realizohen me anë të formave dhe mjeteve të ndryshme të punës, që i përgjigjen moshës së nxënësve dhe qëllimit të mësimin.</p>

- t'i përdorin drejt trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave vetorë në rasën dhanore dhe në rasën kallëzore; -t'i përdorin drejt trajtat e shkurtra në mënyrën urdhërore.	- Përdorimi i trajtave të plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë	- Trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave vetorë	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të trajtave të shkurtra dhe të plota në numrin njëjës dhe shumës (në tekstet e zgjedhur me kujdes, nxënësit i gjejnë trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave dhe e përvetësojnë përdorimin e trajtave të shkurtra para foljeve, në fund të foljeve dhe në trup të foljeve...).
KREU II: Histori e gjuhës			
- të njihen me gjuhën shqipe si gjuhë indoevropiane, me vjetërsinë dhe kontaktet e saj me gjuhët e vjetra indoevropiane; - të thellojnë njohuritë mbi dokumentet e para të shkruara të gjuhës shqipe dhe shkaqet e dokumentimit të vonshëm të saj si gjuhë e shkruar.	- Gjuha shqipe - gjuhë indoevropiane - Dokumentet e para të shkruara të gjuhës shqipe	- Origjina e gjuhës shqipe - Dokumentet e para të shkruara të gjuhës shqipe	- Lexohen të dhëna të përzgjedhura mbi origjinën dhe vjetërsinë e gjuhës shqipe; - Përmes shembujve dhe teksteve të shkruara njihen me emërtimet e ndryshme mbi bazën arb / alb: Albanenses, Albanese, Albanais, Arbanas, Albanac, Arvanit, Arnavut (me metatezë: arnaut)... - Nga leximi i fragmenteve të zgjedhura nga shkrimet e vjetra të shqipes nxënësit mësojnë se emërtimi Shqiptar është i ri në krahasim me emërtimet tjera...
- të njihen me Kongresin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe (Manastir 1908) dhe me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë1972).	- Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe - Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe	- Kongresi i Alfabetit - Kongresi i Drejtshkrimit	- Shikohen dokumentarë që hedhin dritë mbi këto ngjarje të rëndësishme për kulturën shqiptare dhe shkruhen pastaj hartime/ese me të njëjtën temë...
- të njihen me shtrirjen gjeografike të dialekteve të gjuhës shqipe dhe me dallimet kryesore mes tyre.	- Gjuha letrare dhe dialektet e gjuhës shqipe	- Dialektet e gjuhës shqipe	- Ushtrime me tekste përkatëse për t'i njohur e për t'i dalluar dialektet e gjuhës shqipe.
KREU III: Fjalët e ndryshueshme			
- t'i dallojnë përcaktuesit e shprehur me emër, mbiemër, përemër e numëror.	- Përcaktuesit e emrit	- Përcaktuesit e emrit	- Me anë të teksteve të zgjedhura arsimtari do t'i ushtrojë nxënësit të dallojnë përcaktuesit e shprehur me emër, mbiemër, përemër etj.
- ta njohin rolin karakterizues të mbiemrit i cili shpreh një cilësi a një tipar të emrit dhe përshtatet me të në	- Mbiemri si karakterizues i emrit	- Mbiemri	- Ushtrime për njohjen e mbiemrit si përcaktues i emrit; me përemrin vetor dhe trajtat e shkurtra si dhe me rolin e tyre që

gjini, numër dhe në rasë, ndërsa në fjali shprehet me funksion të një përcaktuesi (përcaktori).			kanë për kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.
- t'i përdorin drejt përemrat lidhorë dhe përemrat e pacaktuar; - t'i njohin veçoritë kuptimore dhe gramatikore të përemrave lidhorë dhe të pacaktuar dhe përdorimin e drejtë të tyre.	- Përemri lidhor dhe i pacaktuar	- Përemri lidhor - Përemri i pacaktuar	-Ushtrime me shembuj ku përdoren përemrat lidhorë dhe përemrat e pacaktuar ku nxënësit do t'i gjejnë dhe do t'i shpjegojnë format dhe funksionet e tyre në grupin emëror ose në fjali.
- t'i njohin format dhe funksionin e foljeve ndihmëse kam dhe jam në formimin e kohëve të përbëra të foljes në funksion të kallëzuesit emëror, si dhe foljet gjysmëndihmëse me mënyrën lidhore.	- Foljet ndihmëse dhe foljet gjysmëndihmëse	- Foljet ndihmëse - Foljet gjysmëndihmëse	- Ushtrime për përvetësimin e foljeve ndihmëse dhe gjysmëndihmëse dhe foljeve me ngjyrim emocional. Mjetet: libri i gramatikës dhe i letërsisë, fletëzat mësimore, grafoskopi, videoshiriti etj.
- të njihen me veçoritë e foljes; - të aftësohen t'i zgjedhojnë foljet dhe t'i përdorin drejt në komunikimin e përditshëm.	- Veçoritë e foljes	- Folja	- Ushtrime me tekste të përzgjedhura ku nxënësit do t'i klasifikojnë foljet në zgjedhime dhe në vetë, numër, kohë e mënyra të ndryshme...
- të aftësohen t'i përdorin drejt foljet e mënyrës kushtore, në të gjitha kohët e saj; - të bëjnë dallimin e përdorimit të foljes në mënyrën kushtore dhe përdorimit të foljes në kohën e ardhme (do të shkoj – do të shkoja); - të njihen me formimin e kohës së tashme të kushtores me pjesëzën do dhe me kohën e pakryer të lidhores; - të njihen me formimin e kohës	- Mënyra kushtore dhe kohët e saj	- Mënyra kushtore	- Përmes ushtrimeve të jenë në gjendje që gjatë komunikimit t'i përdorin drejt ndërtimet e mënyrës kushtore në kohën e tashme dhe në të kryerën, por edhe ndërtimet e kushtores me lidhëzat: <i>në qoftë se, po, sikur, po qe se, në rast se...</i>

së kryer me të tashmen e kushtores të foljeve ndihmëse kam dhe jam + pjesorja e foljes. - të njihen me formimin e mënyrës kushtore me lidhëzat: në qoftë se, po, sikur, po qe se, në rast se etj.			
- të aftësohen t'i përdorin drejt foljet e mënyrës habitore, në të gjitha kohët e saj...	- Mënyra habitore dhe kohët e saj	- Mënyra habitore	- Ushtrime me shembuj ku përdoren foljet në kohë të ndryshme të mënyrës habitore, duke i shpjeguar mënyrat e formimit të tyre.
KREU IV: Përbërësit e fjalisë			
- t'i thellojnë njohuritë për strukturën e grupit emëror dhe për funksionin brenda tij në kuadër të fjalisë ose mendimit të shprehur.	- Struktura e grupit emëror dhe funksionet brenda tij	- Grupi emëror	- Nxënësit do të ushtrojnë të përcaktojnë strukturën e grupit emëror dhe do të njihen me funksionin e tij...
- t'i thellojnë njohuritë për strukturën themelore të fjalisë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe.	- Struktura themelore e fjalisë	- Struktura e fjalisë	- Ushtrime me tekste të ndryshme ku nxënësit njihen me strukturën themelore të fjalisë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe dhe me elementet përbërëse të tyre...
- t'i zgjerojnë njohuritë rreth dallimit dhe përdorimit të rrethanorëve (të vendit, të mënyrës, të shkakut, të qëllimit, të sasisë) si gjymtyrë të dyta të fjalisë.	- Rrethanorët	- Rrethanorët	- Ushtrime për dallimin dhe përdorimin e drejtë të rrethanorëve të vendit, të mënyrës, të shkakut, të qëllimit dhe të sasisë.
- ta kuptojnë funksionin e gjymtyrëve homogjene në fjali (kryefjalë e kallëzues homogjenë, përcaktorë, kundrinorë, rrethanorë homogjenë etj.)	- Gjymtyrët homogjene	- Gjymtyrët homogjene	- Ushtrime për njohjen sa më të mirë të funksionit të gjymtyrëve homogjene në fjali...
KREU V: Tipat e fjalive dhe struktura e tyre			

- t'i dallojnë dhe t'i përdorin tipat e fjalive sipas kumtimit në ligjërim me anë të intonacionit, ndërsa në të shkruar me anë të shenjave të pikësimit.	- Tipat e fjalive	- Tipat e fjalive	- Ushtrime me tekste të zgjedhura, ku nxënësit gjejnë fjali të llojeve të ndryshme, qoftë sipas kumtimit ose përmbajtjes.
- të njihen me rendin e zakonshëm (normal) të përbërësve të fjalisë dhe rendin e anasjelltë.	- Rendi i fjalëve në fjali	- Rendi i fjalëve në fjali	- Ushtrime për njohjen e rendit të zakonshëm (normal) të përbërësve të fjalisë...
KREU VI: Tipat e fjalisë dhe struktura e tyre			
- ta dallojnë fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbëra (periudha); - të njihen me strukturën e fjalive të përbëra pa lidhëza dhe me fjalë lidhëse...	- Fjalia e thjeshtë dhe fjalia e përbëra	- Fjalia e thjeshtë - Fjalia e përbëra	- Ushtrime për gjetjen e fjalive të përbëra në tekste të ndryshme; - Ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalive të tipave të ndryshëm (të thjeshta dhe të përbëra).
- ta kuptojnë mënyrën e shprehjes dhe karakteristikat kohore të veprimit (çastin dhe shtrirjen e veprimit në kohë) në fjalitë e thjeshta dhe në fjalitë e përbëra.	- Rrethanori i kohës	- Rrethanori i kohës	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të rrethorëve të kohës si gjymtyrë të dyta të fjalisë; ushtrime për dallimin e gjymtyrëve homogjene dhe funksionet e tyre... Mjetet: libri i gramatikës, libri i letërsisë, fletëza mësimore, videoshiriti, grafoskopi, kompjuteri etj.
- të dallojnë mënyrën e shprehjes së qëllimit dhe të shkakut në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbëra.	- Rrethanori i qëllimit dhe i shkakut	- Rrethanori i qëllimit - Rrethanori i shkakut	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të rrethorëve të qëllimit dhe të shkakut.
- t'i dallojnë mënyrat e shprehjes së kushtit në fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.	- Rrethanori i kushtit	- Rrethanori i kushtit	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të rrethorëve të kushtit.
- t'i identifikojnë mënyrat e shprehjes së lejimit në fjalitë e thjeshta dhe në fjalitë e përbëra.	- Rrethanori i lejimit	- Rrethanori i lejimit	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të rrethorëve të lejimit.
- t'i dallojnë mënyrat e ndërtimit të fjalive të përbëra me më shumë se dy pjesë;	- Fjalia e përbëra me më shumë se dy pjesë	- Fjalia e përbëra...	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalive të përbëra me më shumë se dy pjesë dhe radhitja e pjesëve të tyre sipas rendit të

- të njihen me mjetet e lidhjes së fjalive të përbëra.			zakonshëm... Mjetet: libri i gramatikës, i letërsisë, literatura ndihmëse, grafoskopi, fletëzat mësimore etj.
- të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejt fjalitë e nënrenditura përcaktore dhe të njihen me funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjës së pikësimit...	- Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore	- Fjalitë e nënrenditura përcaktore	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalive përcaktore me mjetet lidhëse (me ndajfoljet: <i>ku, gjer ku...</i> ; lokucionet: <i>për ku, nga ku...</i> ; lidhëzat: <i>se, që, sikur, nëse</i> etj.; - Ushtrime për ta kuptuar se funksionin që e kryen përcaktori në fjalinë e thjeshtë, e kryen dhe fjalia e nënrenditur përcaktore... Mjetet: Gramatika, libri i leximit, grafoskopi, fletëzat mësimore. Format e punës janë të kombinuara...
- të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejt fjalitë e nënrenditura kohore dhe vendore dhe të njihen me funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjës së pikësimit...	- Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur kohore dhe vendore	- Fjalitë e nënrenditura kohore - Fjalitë e nënrenditura vendore	- Përmes ushtrimeve të ndryshme të jenë në gjendje t'i dallojnë dhe t'i përdorin fjalitë kohore dhe vendore me mjetet lidhëse me fjalinë kryesore: <i>para, përpara, porsa, pasi; kur, tek, si ku, gjer</i> , lokucionet <i>për ku, nga ku</i> etj.
- të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejt fjalitë e nënrenditura shkakore dhe rrjedhimore dhe të njihen me funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjës së pikësimit...	- Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur shkakore dhe rrjedhimore.	- Fjalitë e nënrenditura shkakore - Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore	- Ushtrime për dallimin e fjalive të nënrenditura shkakore e rrjedhimore dhe për përvetësimin e mjeteve me të cilat ato e shprehin shkakun dhe rrjedhimin: <i>se, pse, sepse, sapo, gjersa, për arsye se, për shkak se, nga shkakun që; aq sa, kaq sa, saqë, i atillë sa</i> etj.
- të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejt fjalitë e nënrenditura mënyrore e krahasore dhe të njihen me funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjës së pikësimit...	- Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur mënyrore dhe krahasore	- Fjalitë e nënrenditura mënyrore - Fjalitë e nënrenditura krahasore	- Ushtrime për njohjen sa më të mirë të fjalive të nënrenditura mënyrore e krahasore dhe përdorimin praktik të tyre gjatë komunikimit; - Ushtrime për njohjen e mjeteve lidhëse me të cilat ato e shprehin mënyrën dhe

			krahasimin: <i>ashtu, kështu, sikur, si, siç; nga sa, aq...aq sa</i> etj.
- të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejt fjalitë e nënrenditura qëllimore, kushtore e lejore dhe të njihen me funksionin e tyre, ndërtimin, rendin e pjesëve dhe përdorimin e shenjës së pikësimit...	- Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur qëllimore, kushtore dhe lejore	- Fjalitë e nënrenditura qëllimore - Fjalitë e nënrenditura kushtore - Fjalitë e nënrenditura lejore	- Ushtrime për dallimin e fjalive të varura qëllimore, kushtore dhe lejore nga fjalitë kryesore dhe mjetet me të cilat ato e shprehin qëllimin, kushtin dhe lejimin: <i>në qoftë se, në rast se, po qe se; me qëllim që, në mënyrë që; ndonëse, megjithëse</i> etj. Mjetet: Gramatika, libri i leximit, grafoskopi, fletëzat mësimore. Format e punës janë të kombinuara...

FUSHA PROGRAMORE: LETËRSI DHE LEKTYRË (50 orë)			
Objektivat	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
Poezia			
Nxënësit: - të dallojnë sonetin dhe poezinë satirike nga llojet e tjera; - të dallojnë elementet e satirës dhe të humorit.	Llojet e poezisë lirike: - tingëllima (soneti) - poezia lirike satirike	- Tingëllima (soneti) - Poezia lirike satirike	- Ushtrime për recitimin dhe analizën e sonetit dhe të poezive satirike.
- të diskutojnë për motivin, idenë dhe temën e poezisë; - të caktojnë në mënyrë të pavarur motivin, temën dhe idenë e një poezie.	- Motivi, tema dhe ideja në poezinë lirike	- Motivi, tema dhe ideja	- Ushtrime për të zbuluar motivin, temën dhe idenë në poezitë lirike; - Krijime të poezive me motive të caktuara...
- ta kuptojnë ritmin si element kryesor të etrikës; - të dallojnë ritmin dhe elementet e ritmit në poezinë lirike...	- Ritmi si element kryesor i metrikës	- Ritmi	- Ushtrime për të zbuluar ritmin si element kryesor të metrikës...
- t'i njohin, t'i kuptojnë dhe të aftësohen t'i përdorin në të	- Elementet e shprehjes poetike: asindet, polisindet	- Asindet - Polisindet	- Diskutime rreth këtyre elementeve shprehëse; recitimi i poezive ku dallohen

shprehur figurat letrare: asindetin, polisindetin, pyetjen retorike, anaforën dhe epiforën.	polisindetin, pyetja retorike, anafora dhe epifora	- Pyetja retorike - Anafora - Epifora	këto figura dhe analiza e tyre; ushtrime për përdorimin praktik të figurave letrare në poezitë e shkruara nga nxënësit...
PROZA			
- të aftësohen ta bëjnë dallimin në mes tregimit, novelës dhe romanit.	Llojet epike: - tregimi - novela - romani	- Tregimi - Novela - Romani	- Diskutime rreth veçorive të tregimit, të novelës dhe romanit; ushtrime rreth subjektit dhe etapave të tij në një tregim, novelë apo roman...
- të njihen me llojet e romanit historik, shoqëror dhe satirik.	Llojet e romanit: - romani historik - romani shoqëror - romani satirik	- Romani historik - Romani shoqëror - Romani satirik	- Diskutime rreth tematikës së romaneve të lexuara; leximi dhe komentimi i fragmenteve të zgjedhura me kujdes nga ana e arsimtarit...
- të zbulojnë dhe të dallojnë gjëzat nga llojet e tjera të epikës popullore.	Llojet e tjera të epikës: - gjëzat	- Gjëzat	- Diskutime rreth gjëzave; - Ushtrime në grupe rreth gjëzave...
- të dallojnë shtrirjen e subjektit në veprat epike...	Subjekti i veprave epike (tregimit, novelës dhe romanit)	- Subjekti i veprës letrare	- Ushtrime për dallimin e subjektit të veprave të lexuara epike...
- të dallojnë tipin e personazhit - karakterin e tij...	- Tipizimi i personazhëve (caktimi i tipit të personazhit)	- Personazhi i veprës letrare	- Ushtrime rreth tipizimit dhe karakterit të personazhit në një tekst letrar...
DRAMA			
- të ushtrohen të kuptojnë radhitjen e ngjarjeve në dramë	- Radhitja e ngjarjeve në dramë	- Radhitja e ngjarjeve në dramë	- Ushtrime rreth etapave të veprimit të dramës: paraqitja e veprimit, thurja, kulminacioni, peripecia dhe shthurja e veprimit.
- të aftësohen t'i dallojnë elementet letrare nga ato skenike...	- Elementet letrare dhe skenike të drames	- Elementet letrare dhe skenike	- Diskutime për dallimin e elementeve letrare dhe skenike; - Leximi i një pjese dramatike...
- të dallojnë efektet akustike dhe ndriçimin në një realizim dramatik...	- Efektet akustike dhe ndriçimi	- Efektet akustike dhe ndriçimi	- Bisedë rreth efekteve akustike dhe ndriçimit... pas ndjekjes kolektive të një shfaqjeje teatrore...
LLOJET LETRARO-SHKENCORE			

- të njihen me përmbajtjen e udhëpërshkrimit, biografisë, reportazhit...; - të aftësohen të shkruajnë këto lloje shkrimesh letraro-shkencore...	- Udhëpërshkrimi, biografia, reportazhi...	- Udhëpërshkrimi - Biografia - Reportazhi	- Lexime tekstesh të zgjedhura nga ana e arsimtarit dhe ushtrime praktike për shkrimin e udhëpërshkrimit, biografisë dhe reportazhit...
LEKTYRA			
Gjatë vitit shkollor lexohen 8 lektyra			
- të fitojnë shprehje leximi të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj; - të dinë të ritregojnë fabulën e lektyrave të lexuara; - ta përcaktojnë temën dhe idenë e veprave të lexuara letrare; - ta përcaktojnë narratorin llojin dhe gjininë e veprës së lexuar letrare; - të jenë në gjendje të diskutojnë e të shkruajnë për përmbajtjen e veprës së lexuar dhe për karakterin e prsonazhëve...	- Lektyra (tituj të zgjedhur nga letërsia shqipe dhe ajo botërore)	- Lektyra	- Diskutime lidhur me mënyrat e leximit dhe analizës së veprave letraree (lektyrave) sipas planeve të përgatitura paraprakisht nga arsimtari i lëndës; - Ushtrime lidhur me atë që nxënësit do ta shkruajnë në fletoret e tyre, pas leximit të lektyrave...

FUSHA PRGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA (34 orë)			
Format e të shprehurit: të shprehurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim			
Objektivat	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
I. Format e ndryshme të të shprehurit me shkrim			
Nxënësit: - të aftësohen t'i njohin dhe t'i dallojnë format e ndryshme të të shprehurit me shkrim;	- Eseja - Biografia - Autobiografia	- Eseja - Biografia - Autobiografia	- Ushtrime për përvetësimin e formave të ndryshme të të shprehurit me shkrim, duke u mbështetur në shembujt e zgjedhur me

- të aftësohen të shkruajnë ese, biografi , autobiografi, letra zyrtare, ftesa, kërkesa, ankesa, telegrame..., të plotësojnë formularë të ndryshëm etj.;	- Letra zyrtare - Ftesa - Kërkesa - Ankesa - Telegrami - Formulari	- Letra zyrtare - Ftesa - Kërkesa - Ankesa - Telegrami - Formulari	kujdes nga ana e arsimtarit...
II. Lajmërimi			
- të aftësohen të shkruajnë artikuj të ndryshëm gazetareskë sipas modeleve të ofruara nga ana e arsimtarit;	- Arikulli gazetaresk - Ligjerata	- Arikulli gazetaresk - Ligjerata	- Ushtrime praktike për përgatitjen (shkrimin) e artikujve gazetareskë, me ndihmën e arsimtarit të lëndës dhe publikimi i tyre në mediat për fëmijë apo në gazetën e murit;
- të aftësohen të mbledhin të dhënat e nevojshme për përgatitjen e një ligjrate...			- Ushtrime për përgatitjen dhe mbajtjen e ligjeratave lidhur me problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen nxënësit në shkollë dhe në mesin ku jetojnë...
III. Hartimet me shkrim			
- të aftësohen të shkruajnë hartime të bukura, duke i dhënë krahë imagjinatës së tyre...	- Gjatë vitit bëhen 3 hartime me shkrim (një në gjysmëvjetorin e parë dhe dy në të dytin)	- Hartimi	- Ushtrime parapërgatitore lidhur me përmbajtjen, kompozicionin, stilin e të shprehurit, drejtshkrimin dhe pamjen e jashtme të hartimit...

FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIAS (10 orë)			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
Nxënësit: - të njihen me mjetet shprehëse të	- Mjetet shprehëse të filimit:	- Fjala	- Shikimi i filmave të llojeve të ndryshme në

artit filmik dhe me rolin e tyre në përcjelljen e suksesshmë të mesazheve te publiku...	fjala, aktrimi, muzika, kostumografia, efektet akustike, efektet e ndriçimit...	- Aktrimi - Muzika - Kostumografia - Efektet akustike - Efektet e ndriçimit	shkollë dhe në shtëpi dhe komentimi i tyre përpara arsimitarit dhe shokëve të klasës; - Leximi i shkrimeve të ndryshme të siguruara nga ana e arsimitarit për përvetësimin e njohurive rreth artit filmik...
- të aftësohen ta dallojnë filmin nga artet tjera, veçmas nga arti letrar...	- Adaptimi filmik i veprave letrare	- Adaptimi filmik i veprave letrare	- Të shikojnë filma të mbështetur në veprat e njohura letrare dhe të bëjnë dallimin mes filmit dhe veopres lerëre...
- të aftësohen ta krahasojnë filmin, dramën dhe veprën letrare, duke gjetur elementet e ngjashme dhe ato që i dallojnë...	- Krahasimi i filmit, dramës dhe veprës letrare	- Filmi - Drama - Vepra letrare	- Ushtrime për krahasimin dhe dallimin e arteve të ndryshme që kanë dhe elemente të përbashkëta, si filmi, drama dhe vepra letrare...

3. UDHËZIME DIDAKTIKE

Programi mësimor i lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* është përgatitur sipas kërkesave dhe metodave bashkëkohore, duke respektuar parimin e bashkëlidhjes (korelacionit) dhe integritetit të të gjitha fushave programore, në veçanti të fushave programore **Gjuhë** dhe **Letërsi**. Përmbajtjet e lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi (VII-IX) realizohen me anën e të dëgjuarit, të kuptuarit dhe të shprehurit (me gojë dhe me shkrim) të temave nga jeta e përditshme; me anën e të lexuarit dhe analizës së teksteve nga letërsia popullore dhe e shkruar, si dhe të teksteve me përmbajtje shkencore-popullarizuese dhe informative nga libri i leximit, revistat dhe nga burimet tjera. Në përmbajtjet e zgjedhura duhet të mbizotërojnë temat e mirësjelljes, të shoqërimit, të dashurisë, të punës, të gëzimeve të jetës, të paqes e lirisë, të bukurive të natyrës, të kujdesit ndaj ambientit jetësor etj.

Të gjitha përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të jenë në bashkëlidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera: me *gjuhën e huaj* (me qëllim të përvetësimit më të lehtë të terminologjisë, ligjeve dhe rregullave gramatikore të të dy gjuhëve); me lëndën e *historisë* (me qëllim të njohjes me zhvillimin historik të gjuhës, kur analizojnë, fjala vjen, këngë nga cikli i Gjergj Kastriotit, si figurë historike dhe si personazh letrar); me lëndën e *gjeografisë* (me qëllim të njohjes me dialektet e gjuhës shqipe); me *artin figurativ* (me qëllim të paraqitjes figurative të ngjarjeve dhe personazheve të teksteve të interpretuara letrare); me *artin muzikor* (me qëllim të përvetësimit më të mirë të njohurive mbi ritmin, rimën, figurat gjuhësore - asonancën dhe aliteracionin etj.).

Fusha programore *Letërsia dhe lektyra* zë vendin kryesor në mësimdhënien e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* dhe realizohet me leximin dhe përshkrimin e teksteve poetike, epike dhe dramatike, por dhe të teksteve me karakter fantastiko-shkencor dhe informativ, duke pasur gjithnjë parasysh rritjen e shkallëshkallshme të nivelit të njohurive të nxënësve...

Fusha programore *Gjuhë* nuk përfshin vetëm çështjen e përvetësimit formal të gramatikës e të ligjshmërive të saj, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, sepse zotërimi i gramatikës funksionale vihet edhe në funksion të fushave programore *Të shprehurit dhe krijimtaria*, dhe *Kultura e medias*, duke përbërë kështu një tërësi të pandashme gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor.

Përmbajtjet e të gjitha fushave programore burojnë nga tekstet (artistike, gazetareske, shkencore, fantastiko-shkencore...) që shërbejnë si modele për krijimin e teksteve të reja nga nxënësit dhe japin mundësi për realizimin e të shprehurit dhe krijimtarisë (me gojë e me shkrim) në mënyrë sa më të pavarur, sa më origjinale e sa më funksionale.

Gjatë përgatitjes së planeve të punës arsimtari duhet t'i ketë parasysh kushtet që ofron shkolla (mjetet dhe pajisjet mësimore që ka në disponim) për realizimin e procesit mësimor, të përlllogarisë me kujdes kohën e nevojshme (numrin e orëve) për arritjen e objektivave të caktuar dhe të përdorë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies që do t'ia mundësojnë mbylljen e suksesshme të vitit shkollor.

Fushat programore:

- Gjuhë – 50 orë
- Letërsi dhe lektyrë – 50 orë
- Të shprehurit dhe krijimtaria – 34 orë
- Kultura e medias – 10 orë

Fushat programore realizohen gjatë tërë vitit shkollor të ndërlidhura, duke plotësuar njëra-tjetrën.

Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parashikuara sipas fushave programore mund të bëhen shmangie të vogla në pajtim me veçantitë e mjedisit ku ndodhet shkolla dhe nevojat individuale të nxënësve. Po kështu, lejohen edhe disa shmangie që kanë të bëjnë me dendurinë e objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive konkrete. Pra: numri i orëve mund të përshtatet (gjer në një shkallë të arsyeshme...) me nevojat e shkollës së caktuar (mjedisit jetësor prej nga vijnë nxënësit, statusit të tyre kulturor-shoqëror dhe arsimor, përgatitjeve paraprake të nxënësve).

- Qasja e individualizuar ndaj punës edukativo-arsimor

Në bazë të njohurive shkencore për dallimet në zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet përshtatja e mësimdhënies me zhvillimin dhe me nevojat e arritjet individuale të nxënësve. Me fjalë të tjera, nevojitet zbatimi i teknikave dhe strategjive që i kërkon *qasja e individualizuar* me detyra të diferencuara gjatë realizimit të punës edukativo-arsimor me nxënësit. Në këtë mënyrë mund të arrihen më së miri standardet e përcaktuara në fund të ciklit të tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare.

- Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e mësimdhënies

Familja është shkolla e parë për nxënësit dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tyre. Prandaj, gjatë realizimit të objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive në lëndën *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të sigurohet ***komunikimi bashkëpunues me prindërit e nxënësve dhe përfshirja e tyre në punën e shkollës***, në funksion të: zhvillimit dhe përkrahjes së marrëdhënieve prind - nxënës; kultivimit dhe zhvillimit të kulturës së të folurit në familje; realizimit të disa objektivave dhe përmbajtjeve të programit dhe të organizimeve letrare në kuadër të shkollës; informimit të prindërve; këmbimit të përvojave sa u përket specifikave të nxënësit dhe veprimeve ndaj tij etj.

- Mjetet mësimore

- Për realizimin e mësimdhënies së lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*, përveç tekstit themelor, të lejuar nga ministri i arsimit dhe shkencës, këshillohet shfrytëzimi i ***doracakëve të ndryshëm, fletoreve të punës, librit të gjuhës***, të udhëzuesve metodikë për realizimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë edukativo-arsimore...

- **Burimet e të mësuarit në mjedisin e afërt:** resurset e mjedisit që do të vëzhgohen e do të përshkruhen, objekte me karakter kulturor, edukativ, publik dhe shërbyes (dyqan, kinema, teatër, muze, park nacional, bibliotekë, stacion autobusësh etj.), situata me komunikime të ndryshme mes njerëzve në shkollë, në familje dhe në rrethin jetësor.
- **Enciklopedi dhe fjalorë shpjegues** të ndryshëm.
- **Softuerë arsimorë kompjuterikë** për pasurimin e kulturës së të folurit e të kulturës gjuhësore – ***programi toolkid dhe CD-ROM-a të tjerë multimedialë të verifikuar*** me lojëra edukative përkatëse – të verifikuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RM-së.
- **Revista të përshtatshme për moshën e nxënësve**, të verifikuara e të miratuara nga MASH.
- **Krijime letrare** nga autorë të njohur shqiptarë e të huaj (që për nga përmbajtja dhe vlera estetike i përgjigjen moshës së nxënësve)
- **Mjete audio-vizuale, auditive, vizuale dhe mjete të tjera me veti kinetike** – programe televizive, emisione me karakter edukativ, filma të animuar dhe artistikë; videokaseta, disqe të DVD e CD-së me filma të animuar e me filma artistikë dhe me tekste të letërsisë popullore dhe artistike, me ngjarje të regjistruara, ditëlindje, me shfaqje teatrore etj.; audiokaseta me zëra të inçizuar, emisione lajmesh, tekste të lexuara në mënyrë artistike; aplikacione, ilustrime, makete; skena teatrore; sende të lëvizshme me efekte akustike dhe sende të tjera sipas nevojave që kërkon mësimdhënia e kësaj lënde.

4. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

NOTIMI DHE KONTROLLIMI DIAGNOSTIK

Në fillim të vitit mësimor arsimtari bën notim dhe kontrollim diagnostik, me qëllim të verifikimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve të fituara përgjatë vitit shkollor pararendës. Arsimtari mund ta realizojë këtë me ndihmën e instrumenteve të ndryshme: përmes testeve diagnostike, përmes fletëzave anketuese, përmes pyetjeve gojore të përgatitura e të mirëmenduara nga ana e tij, përmes shkrimit të teksteve të shkurta etj.

Rezultatet e fituara paraqesin pasqyrën e njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve dhe si të tilla shërbejnë edhe si pikënisje për planet e mëpastajme për realizimin e Programit mësimor dhe përparimin e procesit kompleks të vlerësimit gjatë vitit shkollor.

NOTIMI FORMATIV

Gjatë kl. IX preferohet edhe vlerësimi formativ që mundëson notimin më objektiv të arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe të caktuar. Këtë tip notimi arsimtari mund ta realizojë me shfrytëzimin e më shumë metodave të notimit:

- bisedave mes nxënësit dhe arsimtarit;
- prezentimeve gojore;
- hartimeve me shkrim;
- testeve;
- detyrave të shtëpisë.
- portfolieve – mbledhjes së treguesve për arritjet e secilit nxënës, siç mund të jenë krijimeve origjinale të nxënësve...

Portfoliet duhet të jenë të njohura për prindërit e nxënësve që edhe ata të mund të kontribuojnë në realizimin sa më të mirë të mësimin të lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Portfoliet e nxënësit plotësohen me të dhëna gjatë viteve të ardhshme shkollore.

Këto metoda të notimit arsimtari mund t'i vlerësojë dhe t'i kontrollojë me lista të veçanta të evaluimit për çdo nxënës, të përgatitura paraprakisht, të cilat plotësohen me çdo aktivitet konkret. Rezultatet e fituara të arritjeve të nxënësve janë të arritshme për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre.

NOTIMI MIKROSUMATIV

Ky lloj notimi praktikohet në fund të çdo tremujori. Ai mbështetet në notimin formativ dhe prej rezultateve të arritura formohen notat e një tremujori për arritjet e nxënësve.

NOTIMI SUMATIV

Në bazë të të dhënave të tërësishme të fituara nga ndjekja dhe kontrollimi i të arriturave të nxënësve gjatë periudhës së realizimit të Programit mësimor, arsimtari e konstaton përparimin e çdo nxënësi veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore. Nga notat e formuara sumative, të formuluara për çdo nxënës, duke u udhëhequr gjithnjë nga nivelet e arritjeve, gjatë një periudhe të caktuar kohore, arsimtari vendos notat përkatëse numerike.

5. KUSHTET HAPËSINORE

Mjedisi i mësimdhënies (klasa etj.) duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Klasa duhet të ketë këndin e bibliotekës, këndin për lojë dhe këndin për ekspozita dhe aktivitete të tjera. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-4061/1 të datës 31.05.2007.

6. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Realizimin e programit mësimor për klasat VII – IX parashikohet ta bëjë mësimdhënësi që ka kryer shkollimin e lartë adekuat që është përcaktuar me Ligjin për arsimin fillor.

Потпис и датум на утврдување на наставната програма

Наставната програма по *албански јазик* за VIII одделение на осумгодишното основно образование, односно IX деветгодишното основно образование, на предлог на Бирото за развој на образованието, ја утврди

на ден

Министер

Никола Тодоров